

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 549/1, datë 20.12.2024

**PËR PROCEDURËN E PAGIMIT TË TARIFËS SË LICENCËS SË PRODHIMIT TË
CANNABIS-it PËR QËLLIME MJEKËSORE DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT
TË KËSAJ TARIFE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 14, pika 9, dhe nenit 43, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive për pagesën e tarifës për pajisen me licencë për prodhimin e *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe për mënyrën e përdorimit të tarifës së licencimit.

II. VLERA DHE MËNYRA E PAGIMIT TË TARIFËS

1. Tarifa e përcaktuar në nenin 14, pika 9, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kjo tarifë është e pakthyeshme.

2. Tarifa do të paguhet nga subjekti që kërkon të licencohet sipas faturës për arkëtim, referuar modelit të miratuar me urdhrin nr. 35, datë 11.11.2009, të ministrit të Financave, “Për miratimin e faturës për arkëtim”.

3. Subjekti, për të proceduar me pagesën, shkarkon nga faqja *neb* e Agjencisë faturën për arkëtim.

4. “Fatura për arkëtim”, paraqitet nga subjekti në bankën e nivelit të dytë për të kryer pagesën.

5. Banka e nivelit të dytë do të pranojë arkëtimin e tarifës vetëm me paraqitjen e faturës së plotësuar me të dhënat sipas modelit bashkëlidhur.

6. Dokumenti i lëshuar nga banka, që vërteton kryerjen e pagesës, dorëzohet pranë Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

III. MËNYRA E PËRDORIMIT TË TARIFËS

Të ardhurat e përfituara nga kjo tarifë arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të thesarit në favor të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe përdoren sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 16.10.2024, “Për procedurën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçi

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj